



Shoqata e të Shurdhërve  
në Prishtinë



ME GJUHËN E SHENJAVE,

**Të Gjithë  
janë të Përfshirë!**



JAVA NDËRKOMBËTARE  
E TË SHURDHËRVE 2018  
12-30 shkurtor 2018



PRISHTINA



Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Kulturës

## ALFABETI DAKTIL

	A		B		C
	Ç		D		Dh
	E		Ë		F
	G		Gj		H
	I		J		K
	L		LI		M
	N		Nj		O
	P		Q		R
	Rr		S		Sh
	T		Th		U
	V		X		Xh
	Y		Z		Zh



Shoqata e të Shurdhërve  
në Prishtinë



Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Kulturës

Shoqata e të Shurdhërve në  
Prishtinë me mbështetjen e  
Drejtorisë së Kulturës

## SHËNON

# DITËN DHE JAVËN NDËRKOMBËTARE TË PERSONAVE TË SHURDHËR

Prishtinë  
23-30 Shtator 2018

**“Me Gjuhën e Shenjave,  
të gjithë janë të përfshirë”**



ME GJUHËN E SHENJAVE,

**Të Gjithë  
janë të Përfshirë!**



JAVA NDERKOMBËTARE  
E TË SHURDHËRVE 2018  
23-30 Shtator 2018



WORLD FEDERATION OF THE DEAF

**Pse është e rëndësishme dita  
ndërkombëtare e gjuhëve të shenjave dhe  
java ndërkombëtare e personave të  
shurdhër?**

### **Informimi dhe Ndërgjegjësimi**

Dita ndërkombëtare e gjuhëve të shenjave dhe Java ndërkombëtare e personave të shurdhër, zhvillohet një herë në vit, për një javë ku bën avokim global për të rritur ndërgjegjësimin për komunitetin e shurdhër, gjuhët e shenjave dhe të drejtat e personave të shurdhër. Qëllimi është të mbledhen së bashku dhe të bashkuar të tregojnë këtë unitet në pjesën tjetër të botës

### **Promovimi i qasjes së hershme në gjuhën e shenjave**

Dita ndërkombëtare e gjuhëve të shenjave dhe Java ndërkombëtare e personave të shurdhër tenton të promovojë gjuhën e shenjave si një parakusht kritik drejt realizimit të plotë të të drejtave të njeriut për personat e shurdhër dhe për të nxjerrë në pah temat që meritojnë vëmendjen. Qasja e hershme në gjuhën e shenjave dhe shërbimet e ofruara në gjuhën e shenjave janë jetike për rritjen dhe zhvillimin e personave të shurdhër. Ky mision është gjithashtu kritik për arritjen e qëllimeve zhvillimore të dakorduara ndërkombëtarisht.

### **Perspektiva unike dhe diversiteti gjuhësor**

Dita ndërkombëtare e gjuhëve të shenjave dhe Java ndërkombëtare e personave të shurdhër mbështet personat e shurdhër nga perspektiva e tyre e aftësisë së kufizuar dhe si minoritetet gjuhësorë. Gjuha e shenjave dhe kultura e shurdhërve njihen si shumëgjuhësi me qëllimin për të promovuar, mbrojtur dhe ruajtur diversitetin gjuhësor dhe trashëgiminë kulturore nga e gjithë bota.

### **Asgjë për ne pa ne**

Gjuhët e shenjave janë gjuhë natyrale të plota, të dallueshme strukturalisht nga gjuhët e folura. Kur punoni me komunitetin e shurdhër duhet të merret parasysh parimi "asgjë për ne pa ne". Referojuni konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, ku përmendet se si gjuhët e shenjave dhe gjuhët e folura janë të barabarta.

### **Parimet kryesore**

Partneriteti i përbashkët midis ditës ndërkombëtare të gjuhëve të shenjave dhe Javës ndërkombëtare të personave të shurdhër inkurajon unitetet ndërkombëtar nëpërmjet mobilizimit të qëndrueshëm, të koordinuar dhe të përhapur. Mesazhet kryesore të fushatës tentohen të shpërndahen nëpërmjet mbulueshmërisë së mirë të medias.